



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
NDËRMARRJA INDUSTRIALE NR.1

Datë . .2026

Nr. _____ prot.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksioni i tarracës në godinën “Poli i Drejtësisë”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime
hidroizolimi 45261420-4**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4 120 000 (katër milion e njëqind e njëzetë mijë) Lekë pa
TVSH.**

PROCEDURA: E Hapur E Thjeshtuar –Punë, bazuar në nenin 49, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar

AFATI I REALIZIMIT TË PUNIMEVE: 7 (shtatë) ditë punë nga momenti i nënshkrimit të procesverbalit të fillimit të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja Industriale Nr.1** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike, llogaritja e Fondit Limit përcillen nga Autoriteti Kontraktor përfitues, i cili kërkon realizimin e punimeve

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2 Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Skedën teknike për materialin hidro-izolues ku të citohet përputhshmëria me materialin izolues si dhe rezistenca ndaj kushteve atmosferike sipas kërkesave të AK të shprehura në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve teknike” të DST .
- b. Operatori ekonomik duhet të jete i autorizuar nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi ose të ketë partneritet me prodhuesin, lidhur me lëndët dhe materialin që kërkohet për realizimin e punimeve me qëllim garantimin e realizimit me sukses të kontrates.
- c. Operatori ekonomik të japë garanci mbi jetgjatësinë e hidroizolimit jo më pak se 10 vite.

Për plotësimin e këtij kriteri OE duhet të paraqes krahas skedës teknike certifikata ose deklarata të konformitetit të bërë nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, të miratuara nga një organ certifikimi që vërteton konformitetin e produkteve të ndërtimit sipas Standarteve europiane ose ekuivalente të tyre.

Dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

Argumentim Ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 1/c të nenit 77 të LPP dhe nenit 40, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Argumentim Teknik: Është kërkuar ky autorizim me qëllim që operatori ekonomik që do të zbatojë kontratën të jetë i autorizuar për shitjen e produkteve. Autorizimi i prodhuesit /distributorit të autorizuar ose partneriteti me prodhuesin është një dokument i rëndësishëm, pasi vërteton mbështetjen e prodhuesit në çdo rast dhe rrethane të pa parashikuar gjatë zbatimit të kontrates, si dhe garancinë mbi jetgjatësinë e rezistencës së materialit i cili nuk duhet të jetë më pak se 10 vite sipas

kërkesave të AK të shprehura në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve teknike” të DST .

2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore per vitet (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo me vogël se 39% e vlerës së përlogaritur të kontratës. *(Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.)*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vitit të kërkuar për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku percaktohet se: ” *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarates të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.4 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.4.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

a. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 45% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kritereve të sipërpërmendura e bën ofertën e kualifikueshme.

b. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudit;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh të deklaruara në organet tatimore.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.

Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 45% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.4.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme;

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP-3A** (Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada).

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **NS-4A** (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese).

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 6, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar; me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e ndryshuar. Referuar kategorisë së kërkuar, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave dhe volumeve të preventivit të punimeve.

Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme
- b) Diplomë

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.4.4 Një punësim prej minimumi 14 (katërmëdhjetë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej minimalisht 14 (katërmëdhjetë) punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit të procesverbalit të fillimit të punimeve, mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”, (ndryshuar me VKM nr.631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriter elementet e struktures së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të t’i dhënë garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, si dhe kohëzgjatjen e saj. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për periudhën 3 muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.4.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- a) 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- b) 1 (një) Inxhinier Hidroteknik

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Për inxhinierët, drejtuesin teknik si mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diplomë;
- CV

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punojesit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve: ndërtimi, hidroteknik, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

Hidroizolues	2
Punonjes te pakualifikuar (te thjeshte)	9
Shofer/Manovratore	1

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.4.6/1 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar si staf teknik si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë per 3- muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 2 (dy) punonjes hidroizolues

Për punonjesit: punonjes hidroizolues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (dëshmi profesionale ose certifikate profesionale që vërteton nivelin e kualifikimit, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
- certifikate te sigurimit teknik leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
- Për punonjës in e thjeshtë duhet të paraqesë: kontratën individuale të punës të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesë në 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- Për punonjës it e thjeshtë duhet të paraqesë: kontratën individuale të punës të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesë në 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

2.4.6/2 Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR. *(Në rastin kur punonjës it Manovrator/shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të

formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike.

2.4.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë “.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve

që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të cënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.4.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a. Certifikatën e cilësisë së punimeve **SSH EN ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **SSH EN ISO 14001-2015** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c. Certifikatën **SSH ISO 45001:2018** ose **SSH EN ISO 45001-2023** (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë) ose ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.4.8 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të*

njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2023 është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike të parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Certifikatat e kërkuara sipas pikës 2.4.8 gërma “a”- “c”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Certifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.4.9 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr.	Lloji i makinerive/pajisjeve	Statusi	Sasia
1	Kamion me vinç mbi 3 ton	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
2	Skeleri	Ne pronesi ose me qira	3000 m2
3	Gjenerator	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
PAJISJE MBROJTESE			

Kokore	14 copë
Jeleke	14 copë
Kuti te ndihmës së shpejtë	2 cope
Tabela sinjalistike mbrojtese	5 cope

- a) Për makineri teknologjike dhe mjete që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: certifikatë pronësie, leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, siguracionin;
- b) Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- c) Për makineri teknologjike dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë teknologjike), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
- d) Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimit ose faturë tatimore blerje) dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- e) Për paisjet kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontratë blerje ose faturë zhdoganimit ose faturë tatimore blerje.
- f) Ndërsa për paisjet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.
- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilën makineri teknologjike dhe mjete dhe paisje të deklaruar.
- h) Për makineritë teknologjike dhe mjetet, fotoja duhet të ketë të dallueshme edhe targën e mjetit.
- i) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); c) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit). Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve dhe grafikut të punimeve pra vërteton se ofertuesi i mundshëm zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...”, sjellim në vëmendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit do t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s’kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuesë, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Të gjitha dokumentet duhet në gjuhën shqip dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

TITULLARI AUTORTITETIT KONTRAKTOR
